

USHTRIMI 8 NGA LËNDA “Principet e Avancuara të Gjuheve të Programimit”

1. Të lexohet, char për char, file-i **“fshk.txt”** dhe të numërohet sa herë është paraqitur fjala **FSHK**.

Në fund të shkruhet në file-in **“fshk.out.txt”** teksti si vijon:

- a) Në rast se është gjetur ndonjë fjalë FSHK të shkruhet:

Në file-in {emri i file-it} u gjeten {x} fjale FSHK

- b) Në rast se nuk është gjetur asnjë fjalë FSHK të shkruhet:

Në file-in {emri i file-it} nuk u gjete asnje fjale FSHK

2. Të punohet ushtrimi 1 por të lexohet file-i rresht për rresht
3. Gjeneralizoni aplikacionin e tuaj që të pranoj si input (parametër hyrës) emrin e file-it hyrës (nga ku lexoni), si dhe fjalën të cilën kërkoni.
4. Krijoni klasën **LinesWithX** që si parametër në konstruktor merr emrin e file-it, **p.sh. “shk2.txt”**. Ofroni metodën **countLines** që si rezultat kthen sa rreshta në file-in e kërkuar e përmbajnë shkronjën **X**.

Rezultati duhet të shkruhet në file-in **shk2.out.txt**, si vijon:

Numri i rreshtave ne file-in <emri_i_file-it> që e permbajnë shkronjën X eshte: <nr_rreshtave>

Ofroni edhe metodën **main()** ku krijohet një instancë e **LinesWithoutX** prej nga thirret metoda **countLines** e kësaj instance.

5. Krijoni klasën **LineMaxChar** që merr si parametër emrin e file-it në konstruktor, **p.sh. “fshk.txt”**, ku do të ofroni metodën **findMaxChar** që si rezultat rreshtin e fundit më të gjatë. Rreshti i parë paraqitet në pozitën 1.

Rezultati duhet të shkruhet në file-in **fshk.out.txt**, si vijon:

Rreshti i fundit më i gjatë gjendet në rreshtin: <nr_rreshtit>

Ofroni edhe metodën **main()** ku krijohet një instancë e **LineMaxChar** dhe të thirret metoda **findMaxChar** e kësaj instance.

6. Krijoni klasën **LineMaxWord** që merr si parametër emrin e file-it në konstruktor, **p.sh. “fshk.txt”**, ku do të ofroni metodën **findMaxWord** që si rezultat kthen fjalën më të gjatë në tekst.

Rezultati duhet të shkruhet në file-in **fshk.out.txt**, si vijon:

Fjala më e gjatë është fjala: <fjala>

Ofroni edhe metodën **main()** ku krijohet një instancë e **LineMaxWord** dhe të thirret metoda **findMaxWord** e kësaj instance.

USHTRIMI 8 NGA LËNDA “Principet e Avancuara të Gjuheve të Programimit”

7. Krijoni klasën **LineMaxWords** që merr si parametër emrin e file-it në konstruktor, *p.sh. “fshk.txt”*, ku do të ofroni metodën **findMaxWords** që si rezultat rreshtin e parë me më shumë fjalë. Rreshti i parë paraqitet në pozitën 1.

Rezultati duhet të shkruhet në file-in *fshk.out.txt*, si vijon:

Rreshti i parë me më shumë fjalë gjendet në rreshtin: <nr_rreshtit>

Ofroni edhe metodën **main()** ku krijohet një instancë e **LineMaxChar** dhe të thirret metoda **findMaxChar** e kësaj instance.

8. Krijoni klasën **LineCounter** që si parametër në konstruktor merr emrin e file-it, *p.sh. fshk.txt*. Ofroni metodën **countLines** që si rezultat kthen numrin total të rreshtave në file-in e kërkuar, si dhe numrin e rreshtave gjatësia e të cilave është numër çift dhe e përmbajnë tekstin **SHK2** (case sensitive).

Rezultati duhet të shkruhet në file-in *fshk.out.txt*, si vijon:

<emri_i_file-it> ka:

<nr_total_rreshta> në total.

<nr_rreshtave> gjatesia e te cilave eshte numer çift dhe e permbajne tekstin SHK2

Ofroni edhe metodën **main()** ku krijohet një instancë e **LineCounter** prej nga thirret metoda **countLines** e kësaj instance.